




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Rruga „Isa Boletini“ nr.44, Tel.028/571-524, E-mail: xhafer.sh.tahiri@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	<b>Komisioni:</b> Haki Maloku  Ismet Gashi  Blerim Zhabari  Isak Hyseni 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për implementimin e Planit të Integritetit për vitet 2016-2018

Të nderuar anëtar të kuvendit të komunës,

Në shtojcë, keni të bashkëngjitur Raportin për implementimin e Planit të Integritetit për gjysmën e dytë të v. 2016, vitin 2017 dhe 2018, i hartuar nga komisioni i themeluar me vendim të kryetarit të komunës.

Raporti është hartuar bazuar në të dhënat që janë marrë nga bartësit e aktiviteteve të përfshirë në këtë plan.

Me respekt!

**R A P O R T**  
**PËR IMPLEMENTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR VITET 2016 – 2018**

Planin e integritetit i aprovuar nga kuvendi i komunës ka për synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike komunale, që të luftohet çdo mundësi e paraqitjes së situatave me elemente korruptive, që të vetëdijesohen dhe inkurajohen qytetarët për të raportuar rastet e korrupsionit, të ngritet niveli i përgjegjësisë në menaxhimin e buxhetit të komunës dhe pronës komunale etj.

Problemi të luftës kundër korrupsionit si dukuri që e mundon shoqërinë tonë në përgjithësi i është dhënë rëndësi përmes planit të integritetit të aprovuar në kuvendin e komunës.

Gjithashtu, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në kuadër të sistemit të menaxhimit të performancës në ofrimin e shërbimeve komunale, nga viti 2016 ka instaluar treguesit shtesë të sistemit të menaxhimit të performancës komunale përkatësisht raportimin e planit të integritetit në baza vjetore. Në vijim të këtij raporti keni të paraqitur realizimin e planit të integritetit për secilën pikë veç e veç.

**PLAN I INTEGRITETIT I KOMUNËS SË VUSHTRRISË 2016 – 2019**

<b>Nr.</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Bartës i aktivitetit</b>	<b>Afati</b>	<b>Treguesit e suksesit</b>	<b>Realizuar 2016-2018</b>
1.	Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	1.Prokurimi online;	1. Drejtorja e Prokurimit; 2. Drejtoritë tjera të Komunës; 3. Institucionet arsimore dhe shëndetësore.	Korrik 2016 dhe në vazhdimësi	Numri (totali) i prokurimeve online	1.Deri më tani janë proceduar 206 prokurime online.1. Sa i përket objektivave që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien, në zbatimin e detyrave që kanë të bëjnë me Planin e integritetit të Komunës së Vushtrrisë 2016-2019, është shënuar progres.

		<p>2. Ndërtimi i bashkëpunimit të qytetarëve, shoqërisë civile me organet e komunës - instalimi i praktikës “karrigë e lire” në kuvendin e komunës, e rezervuar për anëtarët e shoqërisë civile;</p>				<p>Madje ky progres është konstatuar edhe nga vlerësimet e jashtme që i janë bërë Komunës së Vushtrisë.</p> <p>Progresi më i madh sidomos në vitin 2018, është bërë në fushën e prokurimit online, ku nga Zyra e Komunikimit me Publikun, janë publikuar 100 % të dokumenteve të procedurave të prokurimit, që janë të publikuara në fagen e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP).</p> <p>Gjithashtu që nga pranvera e vitit 2018, ZKP ka publikuar edhe të gjitha kontratat që Komuna e Vushtrisë ka lidhur me operatorët ekonomik.</p> <p>2. Në mbledhjet e kuvendit kanë marrë pjesë sa herë që kanë genë të interesuar, qytetarë përkatësisht përfaqësues të shoqërisë civile</p>
--	--	--	--	--	--	--

	<p>3. Instalimi i mekanizmit efikas për respektimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.</p>			<p>1. Numri i rasteve të raportuara; 2. Numri i rekomandimeve të miratuara dhe të zbatuara</p>	<p>3. Kryetari i komunës ka ngarkuar auditorin e brendshëm të komunës që të përcjell dhe mbikëqyrë të gjitha rekomandimet e auditorit të përgjithshëm dhe atij të brendshëm nga raportet e tyre.</p>
<p>2. Vetëdijësimi – inkurajimi dhe rritja e besimit të qytetarëve për raportimin e rasteve të korrupsionit</p>	<p>1. Fushatë vetëdijësimi për raportimin e rasteve të korrupsionit; 2. Organizimi i tryezave me qytetarë inkurajimin e paraqitjes së rasteve të korrupsionit; 3. Vendosja e posterëve në objekte të institucioneve publike dhe në vende të frekuentuara; 4. Inkurajimi i qytetarëve për qasje në dokumente publike konform ligjeve në fuqi. 5. Organizimi i përbashkët i punëtorive (seminareve) kundër korrupsion lidhur me</p>	<p>Zyra e komunikimit me publikun</p>	<p>Qershor 2016 dhe në vazhdimësi</p>	<p>1</p>	<p>Në vitin 2016 dhe 2017, Zyra për Komunikim me Publikun ka bërë vendosjen e posterëve në hapësirat e objektit të Komunës, që kanë të bëjnë me informata dhe adresa të raportimit të mundshëm të korrupsionit.</p> <p>ZKP gjatë kësaj periudhe e sidomos, me rastin e Ditës së Demokracisë ka zhvilluar aktivitete për inkurajimin e qytetarëve për ta shfrytëzuar të drejtën e Qasjes në dokumente publike. Për këto aktivitete, ZKP është përkrahur edhe nga OSBE dhe USAID.</p> <p>Po ashtu gjatë kësaj periudhe zyrtar të Komunës kanë marrë pjesë në punëtori që kanë të bëjnë me aktivitetet e Komunave përkatësisht</p>

	keqëndorimin e pasurisë publike;				institucioneve publike për parandalimin e veprimeve të mundshme korruptive.	
3.	Ngritja e kapaciteteve të institucioneve komunale në luftën kundër korrupsionit	1. Organizimi i trajnimit për zyrtarët e lartë publik dhe të punësuarit – aplikimi i kodeve etike lidhur me parandalimin e korrupsionit; 2. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike – komunale.	Zyra e Personelit	Qershor – Dhjetor 2016	Numri i të trajnuarëve	1. Janë mbajtur trajnime me zyrtar komunal në organizim të përbashkët të komunës dhe USAID-it për sa i përket kodit të etikës ku është përgatitur draft- kodi i etikës i cili do të aprovohet nga kryetari i komunës. 2. Janë avancuar procedurat për kryerje të shërbimeve për qytetarët që nga paraqitja në zyrën pritëse e deri te marrja e dokumenteve. Palët që në momentin e hyrjes në objektin e komunës për të marrë shërbimin e kërkuar bëjnë tërheqjen e numrit sipas radhës me ç'rast ka para vetes monitorin në bazë të të cilit ipen të dhënat se në cilin sportel duhet të paraqitet.

4.	Menaxhimi i pronës komunale konform legjislacionit në fuqi	1. Krijimi dhe përditësimi i regjistrit të plotë të pronave komunale; 2. Instalimi i mekanizmit efikas për zbatimin e gjejeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; 3. Inventarizimi i pasurisë jofinanciare të komunës.	1. Zyra për menaxhimin e pronës komunale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastro dhe Pronë; 2. Kryetari i komunës.	E përhershme	Regjistri i plotë i pronave komunale	1. Drejtoria për Gjeodezi Kadastro dhe Pronë ka krijuar regjistrin e pronave të komunës ku në këtë regjistr janë të përfshira mbi 95% të pronave komunale të regjistruara, gjithashtu janë duke vazhduar punët për të bërë regjistrimin e të gjitha pronave tjera të pa regjistruara. 2. Kjo pikë është e përsëritur – shiqo në nr. rendor 1. Aktiviteti nr. 2.) 3. Në administratën e komunës, shëndetësi dhe arsim bëhet çdo vit inventarizimi i pasurisë jo financiare.
5.	Identifikimi i preziqeve të mundshme te menaxhimi i buxhetit të komunës	1. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional; 2. Përcjellja e implementimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit.	Auditori i Brendshëm i Komunës	Periodike	Numri i raporteve	1. Njësia e auditimit të brendshëm ka marr pjesë në trajnime të vazhdueshme për zhvillim të njohurive dhe shkathtësie profesionale, duke marrë pjesë në 60 orë trajnime brenda dy viteve të njëpasnjëshme në përputhje

					<p>me kriteret e përcaktuara nga Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollat e Brendshme të Financave Publike, me temat nga lëmit e ndryshme sikurse janë :</p> <p>+Rishikimi i Standardeve Ndërkombëtare dhe Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm ; Plotësimi dhe azhurrimi i dosjes së përhershme dhe të përkohshme ; Përgatitja dhe udhëheqja e aktivitetit të prokurimit ; E- prokurimi ; Detektimi i mashtrimit ; Prezentimi i përvojave praktike në fushën e AB, të organizuara nga USAID në bashkpunim me projektin e NJQHAB për Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese e cila ofron asistencë të plotë me fokus për krijimin e sistemeve të cilat përmirësojnë mënyrën e llogaridhënjes për fondet dhe shpenzimet publike.NJAB bazuar në planet vjetore të aprovuara nga ZKA dhe KA përgjatë vitit 2016 ka realizuar 6 raporte, në vitin</p>
--	--	--	--	--	--

					<p>2017 ka realizuar 6 raporte . Për vitin 2018 NJAB bazuar në planin vjetor 2018 ka planifikuar 6 raporte të auditimit , deri në periudhën e raportimit ka realizuar 4 raporte nga të cilat kanë dal 18 rekomandime. Për të gjitha rekomandimet e dhëna janë ofruar planet e veprimit të nënshkruara nga menaxhmenti i audituar dhe ZKA , përgjatë takimit me rastin e prezentimit të raporteve finale</p>
<p>6. Forcimi i kontrollit të menaxhimit të buxhetit të komunës dhe donacioneve</p>	<p>1. Auditimi i pasqyrave financiare; 2. Publikimi periodik i projekteve përfshirë edhe fondin, aktivitetet për çdo projekt të financuar nga donatorët;</p>	<p>1. Auditori i Përgjithshëm; 2. Drejtorja për prokurime dhe zyrtari për donacione.</p>	<p>Vjetor</p>	<p>Raportet e auditimit</p>	<p>1. Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive të përfshira në raporte, zyrtari kryesor financiar dhe auditori i brendshëm i komunës kanë analizuar të gjitha gjetjet dhe rekomandimet në raportet vjetore të auditorit të përgjithshëm për të cilat janë hartuar plane të veprimit për implementim të rekomandimeve dhe me të cilat është njoftuar kuvendi i komunës. 2. Projektet kapitale të realizuara publikohen s'paku dy herë brenda vitit në fagen zyrtare të komunës.</p>

	3. Krijja e transparencës për financimin e qytetarëve dhe OJQ-ve nga grantet dhe subvencionet komunale.			Raportimet të kryetari i komunës	3. Në vitin 2018 i është bërë ftesë publike OJQ-ve të komunës për subvencionim të tyre, bazuar në rregulloren e Qeverisë së Kosovës në fuqi. OJQ-të e komunës kanë aplikuar dhe në procedurë të caktuar ligjore kanë përfutur mjete nga buxheti i komunës.
7. Respektimi i rregullave dhe standardeve të ndërtimit në zonat e urbanizuara	1. Të sigurohet kontroll i vazhdueshëm në terren lidhur me rregullat e ndërtimit;  2. Përfshirja më e madhe e qytetarëve në diskutime publike gjatë hartimit të planeve rregulluese;	Inspektorët e ndërtimit	E përhershme	Raportimet të kryetari i komunës	1. Inspektorët e ndërtimit kanë kryer kontrollime të vazhdueshme në teren në bazë të kërkesave me shkrim të bëra nga investitorët e objekteve të kategorisë së II-të, sipas fazë të ndërtimit. Me qëllim, që me përfundimin e objektit investitorit t'i lëshohet certifikata e përdorimit të objektit të përfunduar sipas projektit kryesor në bazë së cilit ju ka lëshuar leja ndërtimore.  2. Me qëllim të respektimit të rregullave dhe standardeve të ndërtimit në zonat e urbanizuara të gjitha kërkesat e parashtruara për marrjen e Lejes Ndërtimore janë trajtuar konform legjislacion për fushën e

		<p>3. Përfshirja e gyetarëve në diskutime publike për dhënien e kontributit të tyre për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNIM) para dhënies së lejes mjedisore për projektet që kanë ndikim në mjedis.</p>				<p>ndërtimit dhe planifikimit dhe është realizuar përfshirja e gyetarëve në diskutime publike me vendosjen e njoftimeve publike gjatë procedurës së caktimit të kushteve ndërtimore për kategorinë e I dhe II të objekteve për ndërtim .</p> <p>3. Po ashtu të gjitha objektet të cilat kanë pas ndikime në mjedis është kërkuar Leje Mjedisore Komunale, si dhe në konsultim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është bërë përfshirja e gyetarëve në diskutime publike për dhënien e kontributit të tyre për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNIM) para dhënies së lejes mjedisore për projektet që kanë ndikim në mjedis.</p>
8.	<p>Krijimi i mekanizmit të ri lokal në luftën kundër korrupsionit</p>	<p>1. Formimi i Këshillit lokal kundër korrupsionit (KLIK), i përbërë: Kuvendi i Komunës, Qeveria Komunale, Policia, Gjykata, shoqëria civile, ekspert të</p>	<p>Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës</p>	<p>Shtator 2016</p>	<p>1. Funksionimi i Këshillit; 2. Konstituimi i KLIK-së;</p>	<p>1. Nuk është formuar KLIK</p>

		fushës kundër korrupsionit dhe mediart; 2. Hartimi i Rregullores së punës së keshillit; 3. Hartimi i statistikave periodike të ecursionit të rasteve të korrupsionit.			3. Rregullorja e aprovuar dhe plani i punës së KLIK-së.	
9.	Raporti vjetor kundër korrupsionit	Hartimi i raportit vjetor dhe rekomandimet	Këshilli lokal kundër korrupsionit	Vjetore	Raporti	
10.	Parandalimi i konfliktit të interesit për zyrtarët e institucioneve dhe zyrtarët e lartë publik;	1. Shmangia nga vendimmarrja në konfliktin e interesit. 2. Deklarimi i pasurisë të zyrtarëve të lartë publik siç janë: Kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit të komunës, drejtorët e drejtorive, zyrtari kryesor financiar, zyrtarët e Auditimit të Brendshëm dhe inspektorët; 3. Deklarimi i pasurisë brenda mandatit të bëhet çdo vit nga data 01 deri në 31 mars;	Zyra e Personelit	E përhershme	Numri i rasteve të parandaluara	1. Nuk janë evidentuar raste të marrjes së vendimeve të cilat kanë qenë në konflikt interesi me vendim marrësit. 2. Të gjithë zyrtarët publik të komunës të cilët për herë të parë janë emëruar në pozita përkatëse kanë bërë deklarimin e pasurisë brenda afatit ligjorë në formularët për deklaram të pasurisë. Deklarimi i pasurisë është bërë edhe në rastet e përfundimit të mandatit të tyre. 3. Deklarimi i pasurisë është bërë brenda mandatit të tyre përkatësisht nga data 01 deri 31 mars të secilit vit.

	<p>4. Deklarimi i pasurisë me rasiin e emërimit – zgjedhjes në postin publik të bëhet më së largu 30 ditë nga dita e emërimit – zgjedhjes;</p> <p>5. Deklarimi i pasurisë pas përfundimit të mandati të zyrtarit publik të bëhet më së largu 30 ditë nga dita e përfundimit të mandati;</p> <p>6. Pronari i ndërmarrjes – biznesit në të cilin zyrtari i lartë publik ka pronësi apo pjesë të pronësisë, nuk ka të drejt të lidhë kontratë ose të përfitojë ndihmë nga institucioni i komunës, ku zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse;</p> <p>7. Institucionet komunale duhet të sigurojnë që:</p> <p>7.1. Zyrtari i lartë të mos jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues</p>			<p>Formularët për deklaram të pasurisë janë dorëzuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit brenda afatit të përcaktuar ligjor.</p> <p>6. Nuk janë evidentuar raste kur një zyrtar i lartë publik i cili ka pronësi apo pjesë të pronësisë, që ka lidhë kontratë me komunën apo ka përfitur nga komuna, nëse ka qenë në pozitë vendim marrëse.</p> <p>7. Institucionet e komunës kanë siguruar që:</p> <p>7.1. Nuk janë evidentuar raste që bien në kundërshtim me pikën 10 nën pikën 7.1</p>
--	---	--	--	---

	<p>apo kontrollues i ndërmarrjeve private;</p> <p>7.2. Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me prone publike, të mos ketë të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme;</p> <p>7.3. Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë pune nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, të mos mund të pranojë kompensim të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera;</p> <p>7.4. Zyrtari i lartë publik të mos ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë;</p>			<p>(aktiviteti) të planit të integritetit.</p> <p>7.2 Nuk janë evidentuar raste që bien në kundërshtim me pikën 10 nën-pikën 7.2 (aktiviteti) të planit të integritetit.</p> <p>7.3 Nuk janë evidentuar raste që bien në kundërshtim me pikën 10 nën-pikën 7.3 (aktiviteti) të planit të integritetit.</p> <p>7.4 Nuk janë evidentuar raste që bien në kundërshtim me pikën 10 nën-pikën 7.3</p>
--	--	--	--	--

	<p>noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave tjera të përcaktuara me ligjet përkatëse;</p> <p>7.5. Zyrtari i lartë publik te mos ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj;</p> <p>7.6. Zyrtari i lartë i cili përfundon ushtrimin e funksionit publik nuk ka të drejtë për një vit të punësohet ose të emërohet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve;</p> <p>8. Komuna duhet të sigurojë që nëpunësit civil dhe profesional të</p>			<p>(aktiviteti) të planit të integritetit.</p> <p>7.5 Nuk janë evidentuar raste që bien në kundërshtim me pikën 10 nën pikën 7.5 (aktiviteti) të planit të integritetit.</p> <p>7.6 Nuk janë evidentuar raste që bien në kundërshtim me pikën 10 nën pikën 7.6 (aktiviteti) të planit të integritetit.</p> <p>8. Nuk janë evidentuar raste që nëpunësi civil ka qenë vendimmarrës në procedurë</p>
--	--	--	--	--

	përgjashohen nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë gëshyje në të cilën ai apo ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij kanë interes personal ose financiar.				administrative lidhur me ndonjë gëshyje në të cilën ai apo ajo ose ndonjë i afërm i tij/saj kanë pasë ndonjë interes personal apo financiar.	
11.	Sigurimi i masave të veçanta kundër korrupsionit në institucionet publike të komunës	Inicimi në organet kompetente për rastet e dyshuara për korrupsion.	1. Organet kompetente; 2. Qytetarët.	E përhershme	Numri i rasteve të paraqitura.	Nuk ka raste të paraqitura
12.	Forcimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë në nivelin lokal (qeveri dhe kuvend) në realacion me nivelin qendror.	1. Harmonizimi i veprimeve lidhur me vendimet që janë në interes për komunën dhe qytetarët; 2. Komunikimi në mes të pushtetit lokal dhe qendror në fushat e interesit të përbashkët.	Të gjitha institucionet e komunës.	E përhershme	Rezultatet e bashkëpunimit në mes të nivelit lokal dhe qendror.	Është realizuar bashkëpunim i institucioneve të komunës me ato qendrore. Konform dispozitave të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Të gjitha aktet të cilat miratohen në kuvendin e komës si dhe lista e akteve të kryetarit të komunës dërgohen në MAPL.
13.	Rritja e nivelit të përgjegjësisë dhe profesionalizmit në punë të zyrtarëve të institucioneve të komunës	1. Monitorimi i procedurave të punësimit në bazë të meritave dhe raportimi i parregullsive në organet kompetente, veçanërisht gjatë procesit të rekrutimit;	1. Kryetari i Komunës; 2. Zyra e Personelit.	Për çdo fundvit	1. Raportimi i rregullt i monitorimit; 2. Numri i parregullsive të zbuluara (të gjetura) dhe të trajtuara;	1. Me rastin e rekrutimit është siguruar kryesisht punësimi në bazë të meritave. Janë evidentuar 17 raste të ankesave pas përfundimit të procedurave të rekrutimit prej të cilave janë aprovuar 2 ankesa, të tjerat të refuzuara.

		<p>2. Forcimi i rolit të komisionit për ankesa për nëpunësit civil;</p> <p>3. Vlerësimi vjetor i punës së secilit zyrtar publik.</p> <p>4. Organizimi i trajnimeve në fushën e menaxhimit dhe hetimit të korrupsionit brenda institucioneve të komunës;</p> <p>5. Luftimi i dukurisë së nepotizmit në të gjitha fushat.</p>			<p>3. Realizimi i planit të punës;</p> <p>4. Numri i vlerësimeve me nota të dobëta dhe trajtimi i tyre;</p> <p>5. Numri i trajnimeve.</p>	<p>2. Komisioni për ankesa ka genë dhe tani është funksional. Ky komision i ka pranuar dhe shqyrtuar 32 ankesa prej të cilave i ka aprovuar dy raste, ndërsa të fterat i ka refuzuar.</p> <p>3. Është bërë vlerësimi i rregullt vjetorë i nëpunësve civil. Nuk ka pasë raste të vlerësimit me nota të dobëta.</p> <p>4. Disa zyrtar komunal kanë marrë pjesë në trajnime të kësaj fushë.</p> <p>5. Janë bërë dhe bëhen përpjekje për luftimin e nepotizmit dhe ka rezultate në këtë drejtim.</p>
14.	<p>Rishikimi i nivelit të të drejtave diskrecionare (të vendosjes vet në bazë të arsytimit personal) të zyrtarëve institucional</p>	<p>Ngritja e nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjësisë në raport me detyrat e punës.</p>	<p>Të gjithë të punësuarit në sektorin publik në institucionet e komunës</p>	<p>E përherëshme</p>	<p>Numri i rasteve eventuale të shmangies nga obligimet ligjore lidhur me kryerjen e detyrave të punës.</p>	<p>1. Janë shënuar dy raste të suspendimit nga puna të dy zyrtarëve të komunës për shkak se ndaj tyre është ngritur aktakuzë nga prokurori publik.</p>

personal) të zyrtarëve institucional				lidhur me kryerjen e detyrave të punës.	<b>ngritur aktakuzë nga prokurori publik.</b>
<b>15.</b> Ngritja e transparencës lidhur me pranimin e dhuratave të zyrtarëve të institucioneve publike	Krijimi i regjistrit dhe katalogut të dhuratave	Zyra e Personelit	Pas aprovimit të këtij plani	Publikimi në faqe zytare të komunës	<b>Nuk është paraqitur asnjë rast i pranimin të dhuratës prandaj nuk është krijuar regjistri i dhuratave të pranuar.</b>

**Sqarim:** Matja e realizimit të planit të integritetit është bërë në bazë të raporteve të cilat janë marrë nga drejtoritë dhe zyrat të cilat kanë bartëse të aktivitetit.

Radhitja e pikave të realizuara nga plani i integritetit është bazuar në kolonën e dytë – “aktiviteti “ dmth. është marrë për bazë kolona “aktiviteti”.

Komisioni:

Haki Maloku   
 Ismet Gashi   
 Blerim Zhabari   
 Isak Hyseni 





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës - Vushtrri**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **27 dhjetor 2018**, mori këtë:

**VENDIM  
PËR APROVIMIN E RAPORTIT PËR IMPLEMENTIMIN E PLANIT TË  
INTEGRITETIT**

1. Me këtë vendim aprovet Raportit për Implementimin e Planit të Integritetit për vitet 2016-2018 i Komunës së Vushtrrisë.
2. Qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi, është aprovimi raportit lidhur me planin e integritetit, i cili ka për objektive forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në shpenzimin e parasë publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendim është dokumenti me emërtimin Raporti për Implementimin e Planit të Integritetit për 2016-2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**